



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

### Deklaratë e Përbashkët Zotimi

Intensifikimi i reformës drejt avancimit dhe fuqizimit të mëtejshëm të sundimit të ligjit është vënë në pah si nevojë imediate nga procesi i *Rishikimit Funksional të Sundimit të Ligjit*, Raporti i vendit i Komisionit të Bashkimit Evropian, Opinioni i Komisionit të Venecias si dhe raportet dhe vlerësimet tjera nga organizata vendore dhe ndërkombëtare.

Rekomandimet specifike që dalin nga *Strategjia e Sundimit të Ligjit* dhe të riafirmuar nga Raporti i vendit i Komisionit të Bashkimit Evropian dhe Opinioni i Komisionit të Venecias, kërkojnë nga institucionet shtetërore që ta qartësojnë dhe fuqizojnë kuadrin ligjor i cili rregullon punën e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, funksionimin e gjykatave, prokurorive, si dhe mekanizmave të verifikimit, vlerësimit të performancës, disiplinimit, transparencës, integritetit, profesionalizmit, efikasitetit dhe llogaridhënies së gjyqtarëve, prokurorëve, departamenteve dhe njësive respektive të KGJK-së dhe KPK-së.

Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykata Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit me anë të kësaj nisme të përbashkët zotohen për vazhdimin e reformës dhe punën e përbashkët në grupet punuese për vlerësimin, konceptualizmin dhe hartimin e nismave ligjore me synimin e përbashkët për të qartësuar, plotësuar e ndryshuar dhe fuqizuar kuadrin ligjor në fushat e cekura më poshtë:

- Vlerësimi i Performancës së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Procesi i Rekrutimit, Emërimit dhe Riemërimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Sistemi i Disiplinimit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Sistemi i Verifikimit të Profilit të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (gjatë vlerësimit të performancës) si dhe kandidatëve për këto pozita (në fazën e rekrutimit);
- Zhvillimi Profesional i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Forcimi i Mekanizmave për Deklarim të Pasurisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë;
- Statusi i Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Hartimin e Ligjit për Nëpunësit Civil në Administratën e Gjykatave dhe Prokurorive;
- Zbatimi i rekomandimeve nga Misioni i TAIEX për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit (2022), dhe
- Çështje të tjera në kuadër të reformës.

Institucionet nënshkruese përmes kësaj deklarate të nënshkruar, marrim këtë zotim për ta jetësuar këtë pako të reformës ligjore me qëllimin përfundimtar fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Kjo deklaratë e përbashkët zotimi ngërthen në vete sfidat, shqetësimet dhe propozimet që janë ngritur vazhdimisht nga Ministria e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. Tutje, suksemi i kësaj nisme është i lidhur ngushtë me reformat tjera ligjore, të cilat janë në zhvillim e sipër.

Institucionet e mandatuara të drejtësisë, pjesë e këtij zotimi të përbashkët, do të vazhdojnë reformën dhe do të themelojnë grupe punuese të cilat kryesohen nga Ministria e Drejtësisë me përfshirje dhe bashkërendim me institucionet nënshkruese të kësaj deklarate zotuese.


Puna e grupeve të përbashkëta me këtë iniciativë nënkupton koordinimin që nga faza e vlerësimit, konceptimit dhe deri tek dhe finalizimi i nismave ligjore të dakordësuara, e të cilat duhet të adresohen si një pako unike ligjore. Grupet e punës, mund të dakordojnë plan specifik të veprimit.

Kompozicioni, teknikalitetet dhe modaliteti i grupeve punuese janë të hartëzuara në Planin e Veprimit, pjesë integrale e këtij zotimi. Ky Plan Veprimi definon parametrat e punës, qasjen dhe koordinimin ndër-institucional.

Këtij procesi do t'i paraprijë identifikimi i nevojave për ndryshime në legjislacionin që ndërlidhet me sistemin e drejtësisë dhe pastaj varësisht nga vlerësimet, do të diktohet niveli i reformës ligjore duke pasur për fokus çështjet që drejtpërdrejtë ndikojnë në llogaridhënie, efikasitet dhe transparencë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Institucionet nënshkruese të kësaj deklarate në drejtim të zhvillimit dhe finalizimit të kësaj pako të reformës ligjore, nëpërmjet grupeve punuese do t'i bashkërendisin ngushtë aktivitetet me partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë.


Albulena Haxhiu  
Ministre e Drejtësisë



Albert Zogaj  
Kryesues i KGJK-së



Jetish Maloku  
Kryesues i KPK-së



Mejreme Mema  
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme



Besim Kelmendi  
U.D. Kryeprokuror i Shtetit



Prishtinë,  
14/03/2023



